



THIRRJE PËR APLIKIM PËR REGJISTRIM NË PROGRAMIN E DOKTORATËS PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023, PRANË FAKULTETIT TË EKONOMISË UNIVERSITETI I TIRANËS

Dekanati i Fakultetit të Ekonomisë të Universitetit të Tiranës (FEUT), në përputhje me legjislacionin në fuqi, vendosi Hapjen e Aplikimeve për Programin e Doktoratës në Shkenca Ekonomike për vitin akademik **2022-2023**, si vijon:

NËNFUSHA	KUOTAT E PROPOZUARA
EKONOMIKS	13
FINANCË	2
MANAXHIM	6
MARKETING	3
STATISTIKE DHE MATEMATIKE E APLIKUAR NE EKONOMI	4
TOTALI	28

AFATI I APLIKIMIT 25 NËNTOR 2022 – 16 DHJETOR 2022

Hapja e programeve bazohet në legjislacionin si vijon:

Ligji nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”;
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018, “Për Elementet e Programeve të Studimit të Ofruara Nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar.

VKM nr. 112, datë 23.02.2018, “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore ‘Doktor’ dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë ‘Profesor i Asociuar’ dhe ‘Profesor’, i ndryshuar.

VKM nr. 777, datë 26.12.2018, “Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore”, i ndryshuar.

VKM nr. 75, datë 12.2.2018, “Për Miratimin e Modelit të Financimit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor”.

Udhëzimi i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar.

Udhëzimi i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 16, datë 08.07.2019, “Për paisjen e institucioneve të arsimit të lartë me regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave”.

Udhëzimi i përbashkët i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe atij të Financave dhe Ekonomisë nr. 20, datë 20.9.2019 "Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor.

Udhëzimi i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 29, datë 18.12.2019 “Për krijimin dhe administrimin e regjistrave shtetërorë të gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar në Republikën e Shqipërisë”.

Udhëzimi i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 1, datë 14.1.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar me Udhëzimin nr. 7, datë 31.3.2021.

Udhëzimi i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 10, datë 30.3.2020 "Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në Regjistrin Shtetëror të Diplomave dhe Certifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor".

Udhëzimi i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL”.

Statuti i Universitetit të Tiranës.

Rregullore e studimeve doktrale në Fakultetin e Ekonomisë miratuar nga Dekanati i Fakultetit të Ekonomisë më Vendim nr. 10, datë 21.07.2021.

Urdhër i Ministrit të arsimit nr. 156, datë 24.3.2022 “Për riorganizimin e programit të studimit të ciklit të tretë në “Shkenca ekonomike” në Universitetin e Tiranës”.

Fakulteti i Ekonomisë aplikoi për riorganizim të programit të studimit të nivelit të tretë më 20. 4. 2021, sipas akteve ligjore të sipërcituara dhe sipas afateve të parashikuara. Programi i studimit të ciklit të tretë “Doktoratë” u aktivizua me urdhër të Ministrisë së Arsimit në datë 24. 3. 2022.

A. KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI PËR T’U PËRFSHIRË NË PROGRAMIN E DOKTORATËS NË SHKENCA EKONOMIKE NË FAKULTETIN E EKONOMISË, UNIVERSITETI I TIRANËS

a. Të ketë përfunduar studimet e larta në Ekonomi në të paktën njërin nga nivelet e mëparshme të studimeve.

b. Të zotërojë një diplomë të nivelit të dytë, një diplomë të integruar të nivelit të dytë, ose një diplomë sipas sistemit 4-vjeçar, apo nga një program studimi të barasvlershëm, të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga organet kompetente.

c. Të ketë rezultate të larta në secilin nga studimet e ciklit të parë dhe të dytë.

ç. Të ketë mbrojtur një nga gjuhët e huaja: anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht ose spanjisht në përputhje me nivelet e parashikuara në Udhëzimin Nr. 52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e

niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, ndryshuar me Udhëzimin nr. 20, datë 22.09.2017.

d. Të mos jenë marrë masa disiplinore ndaj tij, apo të mos jetë gjetur në shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo shkelje të rregullave kundër plagjaturës, si edhe të vetëdeklarojë se është në gjendje të zbatojë standardet shkencore dhe etike në programin e studimeve.

B. KUSH MUND TË APLIKOJË NË PROGRAMIN E DOKTORATËS PRANË FAKULTETIT TË EKONOMISË

Studimet e doktoratës ofrohen me prioritet për ata persona që e kanë detyrim ligjor kualifikimin e tyre në nivelin e tretë të studimeve, për shkak të punësimit si personel akademik në IAL.

Prioritete të shpallura janë:

1. Personel akademik i punësuar me kohë të plotë në:

- a. Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës.
- b. Fakultetet e ekonomisë të universiteteve të tjera publike dhe jopublike.

2. Staf akademik me kohë të pjesshme i Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës kur është i punësuar me kohë të plotë në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar.

3. Punonjës të institucioneve dhe organizatave publike dhe jo publike, që përfshihen në kërkim bazë ose të zbatuar, aktiviteti i të cilave lidhet me fushat e kërkimit të njësive bazë të Fakultetit të Ekonomisë.

C. DOKUMENTACIONI PËR APLIKIM

Kërkesa e studentit kandidat për të ndjekur programin e studimit të doktoratës në përputhje me fushat e shpallura nga njësia bazë ku aplikon, përfshihet në dosjen personale. **Dorëzimi i dosjes së aplikimit me dokumentacionin e duhur, bëhet pranë Degës së Kualifikimit Shkencor, kati i parë, godina B. Aplikimet pranohen çdo ditë pune në orarin 10.00 - 14.00.**

Dosja e aplikimit duhet të përmbajë dokumentacionin e mëposhtëm dhe pranohet në kushtet kur nuk ka asnjë mungesë dokumentacioni:

- Kërkesë e kandidatit për nënfushën ku do të studiojë.
- Curriculum Vitae.
- Kopje e noterizuar e diplomës dhe listës së notave të studimeve sipas përcaktimeve në rubrikën A.
- Çertifikatë personale dhe fotokopje e kartës së identitetit/pasaportës.
- Dëshmi e gjuhës së huaj (kopje e noterizuar) sipas pikës ç në rubrikën A më sipër.

- Deklaratë vetjake e studentit për përballimin e shpenzimeve të programit të studimeve të doktoratës.
- Vërtetim nga qendra e punës që vërteton se kandidati ka angazhim akademik pranë një institucioni të arsimit të lartë, apo është personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar.
- Mandat pagese për tarifën e aplikimit prej ALL 5 000.
- Vetëdeklarim të aplikantit se do të zbatojë standardet shkencore dhe etike të kërkimit shkencor e publikimit.
- Dëshmi dhe vërtetime në lidhje me kualifikime, trajnime, provime pasuniversitare ose artikuj shkencorë që mund të ketë kryer, apo pjesëmarrje në konferenca shkencore, programe shkëmbimi si Erasmus+, apo projekte kombëtare apo ndërkombëtare. Çertifikata për njohjen e programeve për përpunimin e të dhënave sasiore (Excel të avancuar, Sata, Eviews, SPSS, etj.).

Dokumentacioni i dorëzuar për aplikim, pas përfundimit të procesit, qëndron pranë Fakultetit të Ekonomisë, UT, si i fituesve ashtu dhe i jofituesve.

D. KRITERE SPECIFIKE

Nëqoftëse do aplikohet në programin e studimit Shkenca Ekonomike, nënfusha “Financë” duhet të mbahen parasysh edhe këto kritere specifike:

- Të këtë përfunduar ciklin e parë (Bsc) në fushën e Financës ose të ngjashme me të, dhe ciklin e dytë (Msc), apo Diplomë e integruar e nivelit të dytë, apo diplomë sipas sistemit të vjetër 4 vjeçar, në fushën e Financës.
- Të zotërojë një titull tjetër studimi i fituar në Institucione të huaja të Arsimit të Lartë (pasi të jetë njohur nga institucionet shqiptare përkatëse), ciklin e parë (Bsc) në fushën e Financës ose të ngjashme me të, dhe ciklin e dytë (Msc) në fushat e Financës.

Nëqoftëse do aplikohet në programin e studimit Shkenca Ekonomike, nënfusha “Manaxhim” duhet të mbahen parasysh edhe këto kritere specifike:

- Të këtë përfunduar studimet për Manaxhim, ose në fusha të ngjashme me të, në të paktën një prej cikleve të mëparshme të studimeve, Bachelor dhe/ose Master i Shkencave.

Nëqoftëse do aplikohet në programin e studimit Shkenca Ekonomike, nënfusha “Marketing” duhet të mbahen parasysh edhe këto kritere specifike:

- Të këtë përfunduar studimet në Ekonomi/Marketing/Turizëm ose në fusha të ngjashme dhe/ose të ndërlidhura me to, në të paktën një prej cikleve të mëparshëm të studimeve, Bachelor ose/dhe Master i Shkencave.

Nëqoftëse do aplikohet në programin e studimit Shkenca Ekonomike, nënfusha “Statistikë dhe Matematikë e Aplikuar në Ekonomi” duhet të mbahen parasysh edhe këto kritere specifike:

- Të këtë përfunduar studimet për Informatikë Ekonomike, ose në degë të tjera të Ekonomisë, të Statistikës, Matematikës ose degë të ngjashme me to, në institucione të arsimit të lartë brenda ose jashtë vendit, në të paktën një prej cikleve të mëparshëm të studimeve të ciklit të parë (Bsc) ose të dytë Master Shkencor. Preferohet të këtë marrë njërën nga diplomat në FEUT.

E. FUSHAT KRYESORE TË KËRKIMIT SIPAS NJËSIVE BAZË

Njësia bazë Ekonomiks

Fusha kryesore e kërkimit : Ekonomiks

Nënfushat sipas standardeve ndërkombëtare të kërkimit/shkenca:

Ekonomiks, Politika ekonomike, Histori ekonomie, Ekonometri.

Njësia bazë Financë

Fusha kryesore e kërkimit: Financë

Nënfushat sipas standardeve ndërkombëtare të kërkimit/shkenca: Kodi ISCED – 0411, 0412, 0413, 0416, 0419

Nënfushat kryesore të përcaktuara nga Departamenti i Financës, të cilat përkojnë me nënfushat e mësipërme:

Teoritë financiare dhe Instrumentat financiarë, Ndërmjetësimi financiar dhe institucionet financiare, Financat e Biznesit, Financat publike, Financat e aplikuara, Taksim, Financat ndërkombëtare, Financat personale dhe të sjelljes.

Njësia bazë Manaxhim

Fusha kryesore e kërkimit : Manaxhim dhe Administrim (0413); Biznes dhe Administrim të paklasifikuara diku tjetër (0419)

Nënfushat sipas standardeve ndërkombëtare të kërkimit/shkenca:

- Manaxhimi Strategjik
- Manaxhim Projektsh
- Manaxhim Operacionesh
- Lidërsip
- Manaxhim Burimesh Njerëzore
- Qeverisje Korporatash
- Sjellje Organizative
- Vlerësim Performance

- Manaxhim Ndryshimi
- Sipërmarrje
- Marrje Vendimesh Manaxheriale
- Manaxhim i Cilësisë
- Manaxhimi Organizatave publike
- Administrim Publik
- Planifikimi Strategjik i organizatave publike
- Etika në Organizatat Private/Publike
- Qeverisje në organizatat Publike
- Falimentimi i Bizneseve

Njësia bazë Marketing-Turizëm

Fusha kryesore e kërkimit: Marketing

Nënfushat sipas standardeve ndërkombëtare të kërkimit/shkenca: Kodi ISCED – 0414, 1015, 0419

Marketingu sasior (problemet e aplikuara në marketing), Markimi dhe manaxhimi strategjik i markës, Komunikimi marketing, Sjellja konsumatore, Strategjitë marketing, Marketingu marrëdhënies dhe menaxhimi marrëdhënies me klientët, Manaxhimi kanaleve marketing, Marketingu shërbimeve, Marketingu dixhital dhe neuro-marketing, Marketingu ndërkombëtar, Marketingu social, marketingu institucioneve dhe organizatave jo fitimprurëse, Marketingu sipërmarrës dhe marketingu i gjelbërt, Marketingu i turizmit, Ekonomia e turizmit, Destinacionet turistike, Turizmi i qëndrueshëm, Trashëgimia kulturore dhe natyrore, Aplikimi i teknologjisë në Turizëm, Markimi i destinacioneve dhe manaxhimi i eventeve.

Njësia bazë Statistikë dhe Informatikë e Zbatuar

Fusha kryesore e kërkimit: Statistikë dhe Matematikë e Aplikuar në Ekonomi

Kjo fushë merret me aplikimin e metodave Statistikore dhe Matematikore në fushën e Ekonomisë dhe Vendim-marrjes.

Nënfushat sipas standardeve ndërkombëtare të kërkimit/shkenca:

Statistikë e Aplikuar, Analiza e të dhënave Dizajn i vrojtimit, Vrojtimi me zgjedhje, Aktuaristikë, Statistika matematike, Probabilitet, Matematikë e Zbatuar, Kërkime operacionale.

Pas përfundimit të procesit përzgjedhës emrat e kandidatëve fitues do të shpallen në faqen e Fakultetit të Ekonomisë.

